



REPUBLIKA E KOSOVËS - ШЕДЕТЕСИСЕ - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVSTVA - MINISTRY OF HEALTH

Mjesia Org. Org. Jedinica Org. Unit 02
Nr. J. f. e. gjeve Nr. J. f. e. gjeve 05-7546
Pr. e. f. e. nica Pr. e. f. e. nica
No. pages - 10 - Datum: 01 / 10 / 20 25
Prishtine / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Ured Stalnog Sekretara / Office of the Secretary General

DATË/A:	30.09.2025
PËR/ZA/TO:	Komisioni Parlamentar për Shëndetësi
NGA/OD/FROM:	Z. Jahë Gecaj, UD Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë
CC:	Dr. Arsim Berisha, Zëvendësministër i Shëndetësisë Z. Demë Rexhepi, Udhëheqës i Njesisë së Auditimit të Brendshëm - Ministria e Shëndetësisë Znj. Kadrije Berisha, Zyrtar Kryesor Financiar - Ministria e Shëndetësisë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti për zbatimin e planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve të dalura nga raporti i zyrës kombëtare të auditimit për PVF të vitit 2024 për Ministrinë e Shëndetësisë

Të nderuar, Anëtarë të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi

Bazuar në Rregulloren e punës për zbatimin e Auditimit të planeve të veprimit e miratuar nga Auditori i Përgjithshëm nën 14 pika 5, pas hartimit të Planit të Veprimit, entiteti i auditori i dorëzon Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve. Raportet dorëzohen dy herë në vit, respektivisht deri me 30 Shtator dhe 15 Mars. Bashkangjitur gjeni Raportin për Ministrinë e Shëndetësisë respektivisht nivelin e Adresimit dhe Zbatimit të rekomandimeve të dalura nga raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për PVF të vitit 2024.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

RAPORT PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E
REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT PËR
PASQYRAT VJETORE FINANCIARE 2024 TË MINISTRIË SË SHËNDETËSISË

Prishtinë
Shtator, 2025

RAPORT PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT PËR PASQYRAT
VJETORE FINANCIARE 2024 TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

Nr.	Komponenti i auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra	Statusi i zbatimit	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit
1		Sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), neni 28 kërkon që specifikimet teknike të jenë të qarta dhe të sakta, për të siguruar konkurrencë të barabartë. Pika 7 ndalon çdo referencë direkte apo indirekte ndaj një prodhuesi, marke apo origjine, për të shmangur favorizimin. Sipas nenit 25.7 të Rregullores nr. 001/2022, OE duhet të dorëzojnë dokumente që vërtetojnë përshtatshmërinë profesionale sipas nenit 66 të LPP. Sipas Rregullores nr. 01/2022 për Prokurim Publik, neni 10, njësia kërkuuese përgatit ose propozon detyrën projektuese, specifikimet teknike (ST), Termat e Referencës (TeR), paramasat dhe parallogaritë, duke siguruar që janë në përputhje me nenin 28 të LPP-së dhe nenin 19 të kësaj rregulloreje. Në procedurën e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Istog” me vlerë të kontratës 2,364,143€, Ministria e Shëndetësisë në Dosjen e Tenderit, përkatësisht te paramasa dhe parallogaria ka përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë emra të brendeve të caktuara. Po ashtu, OE fitues kishte paraqitur kontratë të menaxherit të projektit të nënshkruar nga i njëjti person në rolin e punëdhënësit dhe punëmarrësit. Tutje në procedurën e prokurimit "Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar në repartin e pediatriisë në Mitrovicë -Lot 2", me vlerë të kontratës 45,625€, janë evidentuar se disa produkte me përshkrim të njëjtë teknik janë paraqitur si pozicione të ndara me emërtime të ndryshme. Si rezultat, është nënshkruar dhe realizuar	Rekomandimi A1 Ministri duhet të ndërmarrë masa për forcimin e kontroleve të brendshme, me qëllim sigurimin e zbatimit të plotë të kërkesave ligjore gjatë përgatitjes dhe vlerësimit të tenderëve.	Në zbatim të legjislacionit të Prokurimit Publik, akteve nënligjore, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative, sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), neni 28 kërkon që specifikimet teknike të jenë të qarta dhe të sakta, për të siguruar konkurrencë të barabartë. Pika 7 ndalon çdo referencë direkte apo indirekte ndaj një prodhuesi, marke apo origjine, për të shmangur favorizimet. Sipas nenit 19 - Specifikimet teknike - të Rregullores nr. 002/2024, 19.16 ZKA do ta emërojë një person/ekip nga Njësia Kërkuuese, me shkathtësi dhe përvojë të duhur, për hartimin e specifikimeve teknike. Personi/ekipi i emëruar se bashku me Specifikimet teknike do të plotësoj dhe dorëzojë një Deklaratë nën Betim, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP, ku deklaron që specifikimet teknike janë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike janë përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik dhe që Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose	E zbatuar	

RAPORT PËR ZBATIMIN E PLËNIT TË VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT PËR PASQYRAT
VJETORE FINANCIARE 2024 TË MINISTRISË SË SHËNDËTËSISË

		kontrata me çmime të ndryshme për produktin e njëjtë. Këto parregullësi janë rezultat i neglizhencës së personave përgjegjës gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike në procesin e inicimit të procedurës së prokurimit.		ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Në rast që specifikimet teknike hartohen nga kompani të kontraktuara, Deklarata nën betim do të nënshkruhet nga kontraktori. Në rast se specifikimet teknike hartohen nga një ekspert i jashtëm, Deklarata nën betim duhet të nënshkruhet nga eksperti i jashtëm. Kurdo që eksperti i jashtëm mund të sigurohet nga ndonjë autoritet tjetër kontraktues, angazhimi i ekspertit të tillë do të sigurohet me aprovim në mes të dy ZKA-ve. Njësia kërkuese nënshkruan deklaratën nën betim për zbatim të plotë të legjislationit në fuqi. Divizioni i Prokurimit obligohet t'i kërkojë njësisë kërkuese vëmendje që specifikimet teknike të mos jenë të ngushtuara, dhe në përputhje me ligjin, të rishikohen. Në rast të mosrespektimit të këtyre udhëzimeve, Divizioni i Prokurimit obligohet ta njoftojë njësinë kërkuese për shkeljet e konstatuara, ndërsa ZKA-ja ose zyrtari kompetent të ndërmarr veprimet përkatëse në përputhje me legjislationin në fuqi. Organi përgjegjës duhet të ndërmarrë veprimet përkatëse, duke përfshirë edhe njoftimin e organeve kompetente në rast dyshimi për shkelje penale. Ku deri më tani nuk kemi hasur në probleme të tilla.		
--	--	---	--	--	--	--

RAPORT PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT PËR PASQYRAT
VJETORE FINANCIARE 2024 TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

2		Rregullorja Nr. 01/2017 Për Raportimin Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore - Neni 6, përcakton se Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informacionet financiare dhe informacionet tjera jofinanciare. Sipas Neni 16, Raport për të arkëtueshmet, Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave. Më tej Neni 19, obligon organizatat buxhetore të raportojnë vlerën e pasurive jofinanciare, përfshirë stoqet. Llogaritë e arkëtueshme në MSH ishin mbivlerësuar për shkak se në regjistrat e Inspektoratit Shëndetësor ishte prezantuar një gjobë prej 10,000€, edhe pse lënda ishte e përfunduar dhe OE nuk kishte ndonjë obligim ndaj MSH-së. Po ashtu, në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, është evidentuar një mbivlerësim i stoqeve në vlerën 5,008 € si rezultat i dyfishimit të stokut. Ndërsa në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, nuk ishte e mundur konstatimi i gjenjdes reale të stokut për shkak të mungesës së dëshmive bindëse. Gjatë testimit janë ofruara dokumente të ndryshme financiare gjë që e ka pamundësuar vlerësimin e gjendjes së prezantuar në PFV. Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kujdesit të duhur gjatë përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare.	Rekomandimi A2 Ministri duhet të siguroj kontrollë më të forta në përgatitjen e të dhënave në PVF, në mënyrë që ato të prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë.	1.Raportimi i Llogarive të Arkëtueshme të bëhet cdo muaj deri me datën 5 të muajit pasues. 2.Drejtori/Udhëheqës i Administratës monitoron në baza mujore sistemin e E-pasurisë.	<u>E zbatuar</u>	
		Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 37 - "Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivitet e Kushtëzuara", Paragrafi 84 - Për çdo klasë të provizionit, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për: (a) vlerën kontabël neto në fillim dhe në fund të	Rekomandimi A3 Ministri duhet të ndërmarrë masa për të vlerësuar me saktësi mundësitë e	1.Vendimi i Sekretarit për formimin e komisionit për vlerësimin e vlerës financiare të Detyrimeve Kontigjente; 2.Komisioni do t'i identifikoj lëndët të cilat janë pa vlerë financiare;	<u>E zbatuar</u>	

RAPORT PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT PËR PASQYRAT
VJETORE FINANCIARE 2024 TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

3	periudhës. Paragrafi 86 – Përveçse kur mundësia e një daljeje burimesh për shlyerje është e pakët, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për secilën klasë të detyrimit të kushtëzuar në fund të periudhës së raportimit, për një përshkrim të shkurtër të natyrës së detyrimit të kushtëzuar dhe, kur është e mundur: (a) një vlerësim të efektit të tij financiar të përcaktuar në paragrafët 36-52. Organizata buxhetore, në dokumentet e saj burimore, ka paraqitur se nga 701 detyrime totale kontigjente, të cilat janë kryesisht të natyrës së njëjtë, 21% e tyre (ose 150 detyrime kontigjente) nuk kanë një vlerë financiare të përcaktuar. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së vëmendjes nga zyrtarët, të cilët mbajnë evidencat lidhur me detyrimet kontigjente, si dhe mos koordinimit të duhur dhe qartësimin ndërmjet përfaqësuesit (zyrës ligjore) dhe zyrës së financave.	realizimit të detyrimeve kontigjente dhe për të përcaktuar një vlerë financiare të mundshme, për të ofruar një pamje të qartë dhe të drejtë të gjendjes financiare të organizatës.	3.Vlerësimi i përafërt do të bëhet nga njësitë; 4.Përditësimi i Sistemit të Detyrimeve Kontigjente; 5.Insertimi i të dhënave në sistem. 6.Detyrimet Kontigjente raportohen cdo muaj jo më larg se data 10 e muajit pasues te Zyrtari Kryesor Financiar dhe Zyrtari Kryesor Administrativ.		
---	--	---	---	--	--

**RAPORT PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E
REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT PËR PASQYRAT
VJETORE FINANCIARE 2024 TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË**

Gjetja:

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), neni 28 kërkon që specifikimet teknike të jenë të qarta dhe të sakta, për të siguruar konkurrencë të barabartë. Pika 7 ndalon çdo referencë direkte apo indirekte ndaj një prodhuesi, marke apo origjine, për të shmangur favorizimin. Sipas nenit 25.7 të Rregullores nr. 001/2022, OE duhet të dorëzojnë dokumente që vërtetojnë përshtatshmërinë profesionale sipas nenit 66 të LPP. Sipas Rregullores nr. 01/2022 për Prokurim Publik, neni 10, njësia kërkuese përgatit ose propozon detyrën projektuese, specifikimet teknike (ST), Termat e Referencës (TeR), paramasat dhe parallogaritë, duke siguruar që janë në përputhje me nenin 28 të LPP-së dhe nenin 19 të kësaj rregulloreje. Në procedurën e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Istog” me vlerë të kontratës 2,364,143€, Ministria e Shëndetësisë në Dosjen e Tenderit, përkatësisht te paramasa dhe parallogaria ka përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë emra të brendeve të caktuara. Po ashtu, OE fitues kishte paraqitur kontratë të menaxherit të projektit të nënshkruar nga i njëjti person në rolin e punëdhënësit dhe punëmarrësit. Tutje në procedurën e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar në repartin e pediatriisë në Mitrovicë -Lot 2”, me vlerë të kontratës 45,625€, janë evidentuar se disa produkte me përshkrim të njëjtë teknik janë paraqitur si pozicione të ndara me emërtime të ndryshme. Si rezultat, është nënshkruar dhe realizuar kontrata me çmime të ndryshme për produktin e njëjtë. Këto parregullësi janë rezultat i neglizhencës së personave përgjegjës gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike në procesin e inicimit të procedurës së prokurimit.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të ndërmarrë masa për forcimin e kontroleve të brendshme, me qëllim sigurimin e zbatimit të plotë të kërkesave ligjore gjatë përgatitjes dhe vlerësimit të tenderëve.

Dëshmit e Implementimit:

Në zbatim të legjislacionit të Prokurimit Publik, akteve nënligjore, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative, sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), neni 28 kërkon që specifikimet teknike të jenë të qarta dhe të sakta, për të siguruar konkurrencë të barabartë.

Pika 7 ndalon çdo referencë direkte apo indirekte ndaj një prodhuesi, marke apo origjine, për të shmangur favorizimet.

Sipas nenit 19 – Specifikimet teknike - të Rregullores nr. 002/2024, 19.16 ZKA do ta emërojë një person/ekip nga Njësia Kërkuese, me shkathtësi dhe përvojë të duhur, për hartimin e specifikimeve teknike. Personi/ekipi i emëruar se bashku me Specifikimet teknike do të plotësojë dhe dorëzojë një Deklaratë nen Betim, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP, ku deklaronte se specifikimet teknike janë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike janë

përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik dhe që Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenjë dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Në rast që specifikimet teknike hartohen nga kompani të kontraktuara, Deklarata nën betim do të nënshkruhet nga kontraktori. Në rast se specifikimet teknike hartohen nga një ekspert i jashtëm, Deklarata nën betim duhet të nënshkruhet nga eksperti i jashtëm. Kurdo që eksperti i jashtëm mund të sigurohet nga ndonjë autoritet tjetër kontraktues, angazhimi i ekspertit të tillë do të sigurohet me aprovim në mes të dy ZKA-ve.

Njësia kërkuese nënshkruan deklaratën nën betim për zbatim të plotë të legjislacionit në fuqi.

Divizioni i Prokurimit obligohet t'i kërkojë njësisë kërkuese vëmendje që specifikimet teknike të mos jenë të ngushtuara, dhe në përputhje me ligjin, të rishikohen.

Në rast të mosrespektimit të këtyre udhëzimeve, Divizioni i Prokurimit obligohet ta njoftojë njësinë kërkuese për shkeljet e konstatuara, ndërsa ZKA-ja ose zyrtari kompetent të ndërmarr veprimet përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Organi përgjegjës duhet të ndërmarrë veprimet përkatëse, duke përfshirë edhe njoftimin e organeve kompetente në rast dyshimi për shkelje penale. Ku deri më tani nuk kemi hasur në probleme të tilla.

Gjetja:

Rregullorja Nr. 01/2017 Për Raportimin Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore - Neni 6, përcakton se Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informacionet financiare dhe informacionet tjera jofinanciare. Sipas Neni 16, Raport për të arkëtueshmet, Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave. Më tej Neni 19, obligon organizatat buxhetore të raportojnë vlerën e pasurive jofinanciare, përfshirë stoqet. LLogaritë e arkëtueshme në MSH ishin mbivlerësuar për shkak se në regjistrat e Inspektoratit Shëndetësor ishte prezantuar një gjobë prej 10,000€, edhe pse lënda ishte e përfunduar dhe OE nuk kishte ndonjë obligim ndaj MSH-së. Po ashtu, në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, është evidentuar një mbivlerësim i stoqeve në vlerën 5,008 € si rezultat i dyfishimit të stokut. Ndërsa në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, nuk ishte e mundur konstatimi i gjendjes reale të stokut për shkak të mungesës së dëshmive bindëse. Gjatë testimit janë ofruara dokumente të ndryshme financiare gjë që e ka pamundësuar vlerësimin e gjendjes së prezantuar në PFV.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të siguroj kontrolle më të forta në përgatitjen e të dhënave në PVF, në mënyrë që ato të prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Dëshmit e Implementimit:

- 1.Raportimi i Llogarive të Arkëtueshme të bëhet cdo muaj deri me datën 5 të muajit pasues.
- 2.Drejtori/Udhëheqës i Administratës monitoron në baza mujore sistemin e E-pasurisë.

Gjetja:

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 37 – "Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivitet e Kushtëzuara", Paragrafi 84 – Për çdo klasë të provizionit, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për: (a) vlerën kontabël neto në fillim dhe në fund të periudhës. Paragrafi 86 – Përveçse kur mundësia e një daljeje burimesh për shlyerje është e pakët, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për secilën klasë të detyrimit të kushtëzuar në fund të periudhës së raportimit, për një përshkrim të shkurtër të natyrës së detyrimit të kushtëzuar dhe, kur është e mundur: (a) një vlerësim të efektit të tij financiar të përcaktuar në paragrafët 36-52. Organizata buxhetore, në dokumentet e saj burimore, ka paraqitur se nga 701 detyrime totale kontigjente, të cilat janë kryesisht të natyrës së njëjtë, 21% e tyre (ose 150 detyrime kontigjente) nuk kanë një vlerë financiare të përcaktuar. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së vëmendjes nga zyrtarët, të cilët mbajnë evidencat lidhur me detyrimet kontigjente, si dhe mos koordinimit të duhur dhe qartësisht ndërmjet përfaqësuesit (zyrës ligjore) dhe zyrës së financave.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të ndërmarrë masa për të vlerësuar me saktësi mundësitë e realizimit të detyrimeve kontigjente dhe për të përcaktuar një vlerë financiare të mundshme, për të ofruar një pamje të qartë dhe të drejtë të gjendjes financiare të organizatës.

Dëshmit e Implementimit:

- 1.Vendimi i Sekretarit për formimin e komisionit për vlerësimin e vlerës financiare të Detyrimeve Kontigjente;
- 2.Komisioni do t'i identifikoj lëndët të cilat janë pa vlerë financiare;
- 3.Vlerësimi i përafërt do të bëhet nga njësitë;
- 4.Përditësimi i Sistemit të Detyrimeve Kontigjente;
- 5.Insertimi i të dhënave në sistem.
- 6.Detyrimet Kontigjente raportohen cdo muaj jo më larg se data 10 e muajit pasues te Zyrtari Kryesor Financiar dhe Zyrtari Kryesor Administrativ.